

Udhëzues praktikë për prindër/mësimdhënës për **Roblox**

**ROBLOX**


Udhëzuesi përdor pamje reale të aplikacionit dhe shpjegime të shkurtra poshtë tyre.



Roblox: siguria dhe kontrolli prindëror

Lidhni një llogari prindi, pastaj caktoni kufijtë për përmbajtjen, kohën, komunikimin dhe shpenzimet.

Prindi duhet të ketë llogari të veçantë Roblox me privilegje prindërore. Roblox mund të kërkojë verifikimin e moshës së prindit para lidhjes së llogarive.



1

Lidhni llogarinë e prindit

Hapi 1

Në llogarinë e fëmijës, hapni **More** → **Settings**.

Hapi 2


Zgjidhni **Parental Controls**.

Hapi 3

Prekni Add parent dhe shkruani emailin që përdoret në llogarinë Roblox të prindit.

Hapi 4


Hapni emailin e konfirmimit, hyni me llogarinë e prindit dhe pranoni lidhjen.



2

Vendosni nivelin e përmbajtjes



- Hapi 1** Në llogarinë e prindit, hapni **Settings → Parental Controls**.
- Hapi 2** Zgjidhni fëmijën dhe hapni **Content restrictions → Content maturity**.
- Hapi 3** Zgjidhni nivelin që i përshatet moshës dhe pjekurisë së fëmijës.
- Hapi 4** Te **Blocked experiences**, bllokoni lojëra të veçanta që nuk dëshironi të hapen.



3

Vendosni nivelin e përmbajtjes



- Hapi 1** Në **Parental Controls**, te **Screen time** prekni **Manage**.
- Hapi 2** Hapni **Screen time limit**.
- Hapi 3** Te **Daily limit**, zgjidhni kohën maksimale të lejuar për çdo ditë.
- Hapi 4** Kontrolloni **Top experiences** për të kuptuar cilat lojëra përdoren më shumë.



4

Menaxhoni komunikimin

- Hapi 1** Në **Parental Controls**, hapni **Communication** → **Experience chat**.
- Hapi 2** Zgjidhni kush mund të bisedojë publikisht me fëmijën.
- Hapi 3** Kufizoni **Direct chat** dhe **Party** në **Friends** ose **No one**, sipas moshës.
- Hapi 4** Rishikoni listën e miqve së bashku me fëmijën dhe largoni persona të panjohur.



5

Vendosni kufirin e shpenzimeve

- Hapi 1** Në **Parental Controls**, hapni **Spending restrictions**.
- Hapi 2** Zgjidhni **Monthly spending limit**.
- Hapi 3** Shkruani shumën maksimale mujore dhe prekni **Update**.
- Hapi 4** Aktivizoni njoftimet për shpenzime që prindi të njoftohet për blerjet me Robux.

Informacione shtesë

- > Përdorni **Report** për mesazhin, përdoruesin ose përvojën konkrete dhe zgjidhni arsyen e saktë.
- > Përdorni **Block** që personi të mos kontaktojë më fëmijën.
- > Ruani provat dhe njoftoni shkollën ose autoritetet përkatëse kur ka kërcënim, mashtrim, shantazh ose rrezik të menjëhershëm.

